




S. Gëllaj
A. ...



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2536 / Prot.
15

Vlorë më, 06.11.2024

VENDIM

Nr. 64 datë 31.10.2024

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRËTË TË STUDIMEVE, NË
FAKULTETIN E SHËNDETIT, "DOKTORATË NË SHKENCAT E SHËNDETIT"
PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI",
VLORË**

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja dh, nenit, 70, 77, të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", e ndryshuar, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar, si dhe referuar relacionet të Përgjegjesit të Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik, me shkresë 2461/1, prot, datë, 30.10.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.10.2024,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shëndetit, për hapjen e programit të ciklit të tretë të studimit "Doktoratë në Shkencat e Shëndetit", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

A. Saliaj

